



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Prill 2021

Nr: 233

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Donika Hysenaj

Kërkues: Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Dibër

Ndaj: Zj. Donika Hysenaj

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak



Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 7/1 prot., datë 19.03.2021, protokolluar në KQZ me shkresën nr. 2417 prot., datë 19.03.2021, nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë (PD), Dega Dibër, është raportuar një denoncim, me pretendimin se ka shkelje të parashikuar në nenin 37, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 152/2013 të ndryshuar “Për nëpunësin civil”.

Në denoncimin e raportuar pretendohet se: *“Zj. Donika Hysenaj, me funksion Sekretare e Përgjithshme e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, pa marrë në konsideratë pozicionin e punës të cilin ajo ushtron pranë institucionit të Prefektit, i cili në fjalë e privon nga e drejta për të shprehur publikisht bindjet apo preferencat e saj politike, merr pjesë në fushata elektorale me zj. Almira Xhembulla, deputete e Partisë Socialiste dhe Ish-Kryetarin e Bashkisë Dibër; z. Dionis Imeraj, i Partisë Socialiste, nga ku rezulton të jetë përzgjedhur njëkohësisht si pjesë e Asamblesë Kombëtare të kësaj partie. Referuar të dhënave të mësipërme, kërkohet marrjen e masave për rastin konkret”*.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se, të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, Dega Dibër, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijnë procedurën administrative ndaj zj. Donika Hysenaj ndaj të cilës atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9/ 2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 datë 24.10.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimin e raportuar pretendohet se: *“Zj. Donika Hysenaj, me funksion Sekretare e Përgjithshme e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër, pa marrë në konsideratë pozicionin e punës të cilin ajo ushtron pranë institucionit të Prefektit, i cili në fjalë e privon nga e drejta për të shprehur publikisht bindjet apo preferencat e saj politike, merr pjesë në fushata elektorale me zj. Almira Xhembulla deputete e Partisë Socialiste dhe Ish- Kryetarin e Bashkisë Dibër z. Dionis Imeraj i Partisë Socialiste, nga ku rezulton të jetë përzgjedhur njëkohësisht si pjesë e Asamblesë Kombëtare të kësaj partie. Referuar të dhënave të mësipërme, kërkohet marrjen e masave për rastin konkret”.*

Në shkresën e dërguar, është paraqitur si provë lista me emrat e anëtarëve të rinj të Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste e vitit 2020 nga ku rezulton se, zj. Donika Hysenaj është anëtare e kësaj asambleje në qytetin e Dibrës, Qarku Dibër.

Në cilësinë e provës nga denoncuesi është paraqitur dhe një foto ku pretendohet të jetë zj. Donika Hysenaj, në një takim me persona të tjerë, duke shkelur haptazi dhe publikisht ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”.

Me shkresën nr. 1999/1 prot., datë 26.03.2021, protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 2893 prot., datë 31.03.2021, Departamenti i Administratës Publike i ka dërguar për dijeni Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkresën drejtuar Administratës së Prefektit të Qarkut Dibër dhe Minsitrisë së Brendshme,

ku kërkohet shqyrtimi dhe informimi mbi rastin e mësipërm.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3290 prot., datë 06.04.2021, me lëndë “Kërkesë për marrje masash”, i është drejtuar Partisë Socialiste të Shqipërisë, për dijeni Partisë Demokratike të Shqipërisë Dega Dibër dhe Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin të nenit 8, Kreu IV i vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për të marrë masa që zj. Donika Hysenaj, të mos jetë më pjesë e Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për shkak se janë shkelur dispozitat e pikës 1, neni 37, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Me shkresën nr. 126 prot., datë 08.04.2021, protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 3290/1, datë 09.04.2021, Partia Socialiste e Shqipërisë, ka informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se zj. Donika Hysenaj në Kongresin e Partisë Socialiste është zgjedhur si anëtare e Asamblesë Kombëtare në datë 29.02.2021 dhe në muajin mars 2021, është dorëhequr nga ky funksion dhe si delegate e Kongresit të Partisë Socialiste.

III.

Analiza ligjore

Zj. Donika Hysenaj mban pozicionin e Sekretares së Përgjithshme, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër. Referuar ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, neni 19, pika 4, shkronja “a” e klasifikon pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm si pozicion i nivelit të lartë drejtues.

Referuar neni 37, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” parashikohet se, *“Nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues, nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre.*

Referuar neni 35 të statutit të Partisë Socialiste të Shqipërisë, organet drejtuese dhe përfaqësuese të partisë në nivel qendror janë, *“Kongresi i partisë, Asambleja Kombëtare e PS, Kryesia e PS, dhe Kryetari i PS”.*

Sipas denoncimit të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, zj. Donika Hysenaj rezulton të jetë anëtare e Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste.

Referuar neni 8 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve

njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve parashikohet se, “ *Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në rastet kur, kryesisht ose me informacion të paraqitur nga të tretët, konstaton shkelje të detyrimeve të përcaktuara në këtë kre, paralajmëron me shkrim partinë politike, subjektin zgjedhor apo kandidatin në favor të të cilit është kryer veprimtaria e punonjësit, duke i kërkuar ndërprerjen e kësaj veprimtarie dhe marrjen e masave për mospërsëritjen e saj në të ardhmen. Paralajmërimi njoftohet publikisht edhe në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*”

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3290 prot., datë 06.04.2021 i është drejtuar Partisë Socialiste të Shqipërisë, për dijëni Partisë Demokratike të Shqipërisë Dega Dibër dhe Departamentit të Administratës Publike me kërkesë për marrje masash, që zj. Donika Hysenaj të mos jetë më pjesë e Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe me shkresën nr.126 prot, datë 08.04.2021 protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 3290/1 prot., datë 09.04.2021, Partia Socialiste e Shqipërisë, ka informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se zj. Donika Hysenaj, në muajin mars 2021 është **dorëhequr nga ky funksioni i anëtares së Asamblesë Kombëtare dhe si delegate e Kongresit të Partisë Socialiste.**

Sipas përcaktimeve të nenit 6, pika 4, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “*Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucionit, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje*” si dhe pika 5 “*Gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore, nëpunësit civil i ndalohet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat*”.

Nga denoncimi i paraqitur nuk provohet fakti se, zj. Donika Hysenaj në foton bashkëlidhur ka qënë në një veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor apo kandidati për zgjedhje, gjatë orarit zyrtar të punës apo brenda mjediseve të institucionit shtetëror.

Referuar sa më sipër, zj. Donika Hysenaj nuk provohet se ndodhet në kushtet e parashikuar nga neni 37, pika 1 e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe vendimi nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për denoncimin e paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Dibër, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që të vërtetojnë shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj zj. Donika Hysenaj.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me shkresë denoncuesit dhe Departamentit të Administratës Publike.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

